



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**

Nr. 2329 Prot.

Datë 25.02.2026

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.23, datë 25.02.2026

Për masat procedurale dhe administrative për trajtimin e deklarimeve për heqje dorë, kërkesave për zëvendësimin/përjashtimin e prokurorëve dhe zëvendësimi i prokurorëve me iniciativën e Drejtuesit të Prokurorisë

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.7905, datë 27.04.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit nr.3 datë 29.12.2016 "Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori" të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, infomimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan,

UDHËZOJ:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi i udhëzimit**

Ky udhëzim ka për qëllim:

- a. Të standardizojë dhe unifikojë praktikat për shqyrtimin e kërkesave për heqje dorë nga ndjekja e një çështjeje penale nga një prokuror, si dhe për zëvendësimin e tij me një tjetër;
- b. Të përcaktojë qartësisht rastet dhe procedurat e përjashtimit të prokurorit me kërkesë të palëve ose me iniciativë të drejtuesit të prokurorisë;
- c. Të garantojë ligjshmëri, transparencë dhe paanshmëri në veprimtarinë procedurale të organit të prokurorisë.

Neni 2 Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për të gjitha çështjet penale të ndjekura nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹, në rastet kur:

- a. Prokurori paraqet deklarinimin për heqje dorë nga ndjekja e një çështjeje në hetim apo gjykim;
- b. Palët në proces kërkojnë përjashtimin e prokurorit nga ndjekja e një çështjeje në hetim apo gjykim;
- c. Drejtuesi i prokurorisë konstaton, në mënyrë të pavarur, nevojën për zëvendësim të prokurorit nga ndjekja e një çështjeje në hetim apo gjykim.

KREU II DEKLARIMI I HEQJES DORË NGA PROKURORI

Neni 3 Rregulla mbi heqjen dorë

1. Prokurori ka të drejtë të kërkojë heqje dorë nga ndjekja e një çështjeje penale, nëse ekzistojnë rrethana të papajtueshmërisë ligjore, sipas neneve 16² dhe 17³ të KPP;

¹ Në vijim Prokuroria Elbasan

² Neni 16 Papajtueshmëria për arsye lidhjeje familjare, gjinie ose krushqie

1. Në të njëjtin procedim nuk mund të marrin pjesë si gjyqtarë personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim, bashkëshortë, bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave) ose krushqi e afërt (vjenhërr, vjenhërrë, dhëndër, nuse, kumatë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka).

³ Neni 17 Heqja dorë

1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete:

a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij;

b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij;

c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit;

d) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërin prej palëve private;

e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16;

2. Deklarimi për heqje dorë duhet të paraqitet me shkrim, i argumentuar dhe protokollohet në Librin e Korespondencës me Drejtuesin.
3. Drejtuesi i Prokurorisë e shqyrton kërkesën brenda 3 ditëve pune dhe merr vendim të arsyetuar për pranimin ose refuzimin e kërkesës.
4. Vendimi i drejtuesit regjistrohet në Librin e Korespondencës së Drejtuesit të Prokurorisë dhe i njoftohet prokurorit kërkuar, Zyrës së Regjistrimit dhe subjekteve të tjera procedurale nëse kërkohet prej tyre.
5. Në rastet e pranimin të kërkesës për heqje dorë, caktimi i prokurorit kryhet vetëm nëpërmjet shortit, si rregull midis prokurorëve të seksionit që i përket vepra penale.

KREU III ZËVENDËSIMI I PROKURORIT ME KËRKESË TË PALËVE

Neni 3 Parashtrimi i kërkesës

1. Çdo palë në një çështje penale ka të drejtë të kërkojë zëvendësimin e prokurorit, sipas nenit 27⁴ të KPP.
2. Kërkesa duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë:
 - i. Të dhëna mbi identitetin e kërkuar dhe prokurorin për të cilin kërkohet përjashtimi;
 - ii. Përshkrimin e rrethanave që mbështet kërkesën për përjashtimin, sipas nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale;
 - iii. Çdo provë ose indicie mbështetëse, nëse ka.
3. Kërkesa dorëzohet dhe protokollohet në sekretarinë e prokurorisë, regjistrohet në regjistrin e korespondencës së Drejtuesit dhe i kalon menjëherë Drejtuesit të Prokurorisë.

Neni 4 Shqyrtimi dhe vendimarrja

1. Drejtuesi i prokurorisë shqyrton kërkesën brenda një afati prej 3 ditësh pune, për të verifikuar nëse ajo përmban elementët e nevojshëm duke:

ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse i cili e miraton ose e refuzon atë me vendim të arsyetuar.

3. Mbi deklarin e heqjes dorë të kryetarëve të gjykatave vendosin kryetarët e gjykatave të një shkalle më lart. Mbi deklarin e heqjes dorë të kryetarit të Gjykatës së Lartë vendos një trup gjykues i Gjykatës së Lartë i përbërë nga tre gjyqtarë.

⁴ Neni 27 Rastet e zëvendësimit të prokurorit

1. Drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin e prokurorit kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 paragrafi i parë shkronjat "a", "b", "ç", "d" dhe "dh". Në rastet e tjera prokurori zëvendësohet vetëm me pëlqimin e tij.

2. Shfuqizuar.

3. Rregullat e caktuara për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit zbatohen edhe për oficerin e policisë gjyqësore.

- a. njoftuar prokurorin për kërkesën;
 - b. kërkuar informacion për çështjen dhe rrethanat e pretenduara;
 - c. kërkuar qëndrimin e prokurorit në lidhje me kërkesën, kur një gjë e tillë çmohet e nevojshme për shkak të rrethanave të pretenduara.
2. Drejtuesi i Prokurorisë merr vendim të arsyetuar për pranimin ose rrëzimin e kërkesës.
 3. Nëse kërkesa rezulton e bazuar në ligj e në prova, drejtuesi pranon kërkesën për zëvendësimin e prokurorit me një prokuror tjetër, i cili caktohet vetëm nëpërmjet shortit manual midis prokurorëve të seksionit që i përket vepra penale.
 4. Vendimi për pranimin ose refuzimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit i njoftohet kërkuarit, prokurorit të çështjes, Zyrës së Regjistrimit, i bashkëlidhet akteve të çështjes si dhe regjistrohet në Librin e Korespondencës me Drejtuesin.

KREU IV

ZËVENDËSIMI I PROKURORIT NGA DREJTUESI

Neni 5

Iniciativa e drejtuesit të prokurorisë

1. Drejtuesi i prokurorisë mund të vendosë zëvendësimin e një prokurori, edhe pa kërkesë, kur konstaton se ekzistojnë rrethana të papajtueshmërisë ligjore, sipas nenit 27 të KPP.
2. Drejtuesi i prokurorisë mund të vendosë zëvendësimin e një prokurori, edhe pa kërkesë, kur konstaton se ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, të cilat pengojnë vijimin e ndjekjes së çështjes nga prokurori kur ai:
 - a. Sipas vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë i është miratuar leja e papaguar;
 - b. Sipas vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është caktuar/komanduar në një prokurori/institucion tjetër;
 - c. Sipas vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë transferohet apo ngrihet në detyrë në një prokurori tjetër;
 - d. Sipas vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është pezulluar apo shkarkuar nga detyra;
 - e. Në raste të tjera kur është në pamundësi për ndjekjen efektive të çështjes/ve për shkak të ekzistencës të rrethanave objektive që shkaktojnë këtë pamundësi, përfshirë edhe rastet kur shkak është gjendja shëndetësore, e cila dokumentohen me raport shëndetësor afatgjatë dhe sipas të dhënave dokumentare ose

informacionit të përcjellë nga vet prokurori gjendja e paaftësisë së përkohshme për punë do të zgjasë eventualisht.

3. Drejtuesi i prokurorisë mund të vendosë zëvendësimin e një prokurori, kur vihet në dijeni nga prokurori i çështjes, Zyra e Regjistrimit apo në çdo mënyrë tjetër se autor apo viktimë e veprës penale është shtetas i mitur, fakt që sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, dikton domosdoshmërinë që çështja të ndiqet nga një prokuror i Seksionit për të Miturit.
4. Zëvendësimi i prokurorit me një prokuror tjetër kryhet nëpërmjet shortit manual midis prokurorëve të seksionit që i përket vepra penale.
5. Në rast përjashtimor, kur për shkak të veprimeve të ngutshme hetimore, të cilat diktojnë nevojën për zëvendësimin e menjëhershëm të prokurorit me një prokuror tjetër dhe nuk mund të pritët organizimi i shortit manual, prokurori zëvendësohet me prokurorin e planifikuar në gadishmëri ditën që lind urgjenca, sipas grafikut të gadishmërisë. Nëse prokurori që duhet zëvendësuar është njëkohësisht edhe prokuror i planifikuar në shërbim gatishmërie, çështja i caktohet me zëvendësim prokurorit pasues të planifikuar në gadishmëri sipas grafikut të gadishmërisë, nëse shkaqet urgjente nuk mundësojnë organizimin e shortit.
6. Vendimi i zëvendësimit i njoftohet prokurorit që i është caktuar dhe bashkëlidhet akteve të çështjes.
7. Në rastet e dorëzimit tërësor të ngarkesës së një prokurori për shkaqe ligjore, ndiqen rregullime të posaçme sipas urdhërave të Drejtuesit të Prokurorisë për dorëzimin e materialeve, trajtimin dhe rishpërndarjen e tyre.
8. Zëvendësimi sipas pikës 2, gërma “e” të këtij neni është përjashtimor, diskutohet nga Drejtuesi me prokurorin që duhet zëvendësuar dhe drejtuesin e seksionit përkatës dhe përgjithësisht ushtrohet për çështje të natyrës së ngutshme dhe urgjente.

KREU V

DOKUMENTIMI DHE TRANSPARENCA

Neni 6

Dokumentimi i vendimeve

1. Të gjitha vendimet për pranimin ose refuzimin e deklarimeve për heqje dorë të prokurorit, kërkesave për përjashtim dhe zëvendësimin e prokurorit dokumentohen me vendim të arsyetuar.
2. Vendimet regjistrohen në regjistrin e veprimtarive administrative dhe librin e korrespondencës me drejtuesin.

3. Vendimi për pranimin ose refuzimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit i njoftohet kërkuarit, prokurorit të çështjes, prokurorit që caktohet, Zyrës së Regjistrimit dhe i bashkëlidhet akteve të çështjes si dhe regjistrohet në Librin e Korrespondencës me Drejtuesin.
4. Një kopje e praktikës në të cilën përfshihet: deklarimi i heqjes dorë të prokurorit, kërkesa për zëvendësim, aktet që dokumentojnë arsyet e zëvendësimit sipas nenit 5 të këtij udhëzimi, urdherat dhe procesverbalet që shoqërojnë procedurën e zëvendësimit, vendimi për pranimin/refuzimin e zëvendësimit, mbahet nga Sekretare e Drejtuesit.
5. Një kopje e vendimit të drejtuesit i njoftohet Zyrës së Regjistrimit për të bërë shënimet përkatëse në regjistrë, e cila merr masat për dorëzimin e akteve të çështjes tek prokurori që caktohet në rast pranimi të kërkesës për zëvendësim ose të deklarimit të heqjes dorë.
6. Vendimi i Drejtuesit të Prokurorisë që i përket disponimit mbi kërkesën e palëve në proces për përjashtimin e prokurorit i njoftohet subjektit kërkuar (dhe/ose mbrojtësit) kundrejt nënshkrimit ose me shkresë të protokolluar dhe dërguar përmes shërbimit postar në adresën e deklaruar.

Neni 7

Rregullime të përgjithshme

1. Praktika si më sipër ndiqet dhe zbatohet, përsa është e mundur, edhe në rastet e çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, kërkesat në fazë ekzekutimi, kërkesat e tjera penale, kërkesat për parashkrimin e ndjekjes penale si dhe në të gjitha çështjet e tjera problematika e së cilave nuk është përfunduar.
2. Në rastet e çështjeve në fazë verifikimi, prokurori mund të parashtrojë heqjen dorë nga vijimi i verifikimit nëse janë kushtet ligjore, edhe përmes refuzimit të materialit përmes sistemit CAMS. Në këtë rast, Drejtuesi i Prokurorisë bën shënimet e nevojshme në sistem si dhe fizikisht në shkresën e shortimit të materialit. Në rast pranimi të heqjes dorë, ri-shortimi i materialit bëhet nëpërmjet shortit elektronik ndërmjet prokurorëve të tjerë të atij seksioni. Kur kërkohet përjashtimi i prokurorit nga palët e tjera procedurale ose kur zëvendësimi inicohet nga drejtuesi, në rastet e çështjeve në fazë verifikimi, zbatohen rregullat e përcaktuara në nenet 3-5 më sipër.
3. Prokurori i caktuar rishtaz në Prokurorinë e Elbasanit merr ngarkesë sipas akteve rregulluese për çdo rast të veçantë, gjithnjë vetëm përmes shortimit.
4. Ndryshimet në ndarjen e prokurorëve nëpër seksione apo ndryshimet në kompetencat lëndore të seksioneve, si rregull nuk përbëjnë shkak për zëvendësimin, përjashtimin ose heqjen dore të prokurorëve nga çështjet që kanë në verifikim/hetim/gjykim. Nga ky rregull bën përjashtim zbatimi i përcaktimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

5. Në çdo rast të ri-shortimit të një çështje për shkak të heqjes dorë apo zëvendësimit të prokurorit, prokurorët ndërmjet të cilëve do të organizohet rishortimi njoftohen paraprakisht për të marrë pjesë në rishortim. Njoftimi duhet të jetë i dokumentuar.
6. Shortimi manual zbatohet si procedurë deri në funksionimin e sistemit të shortimit elektronik të të gjitha materialeve.

Neni 8

Dispozita kalimtare dhe hyrja në fuqi

1. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe stafi administrativ. Një kopje e këtij udhëzimi iu komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti IT me kryerjen e njoftimit.
2. Një kopje e këtij urdhëzimi i dërgohet Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Deri në plotësimin e organikës me prokurorë dhe përfundimin e rishpërndarjeve të shpeshta dhe tërësore të ngarkesave për shkaqe që lidhen me karrierën e prokurorëve, në rastet e dorëzimit tërësor të ngarkesës nga një prokuror mbahet në konsideratë detyrimi për të bërë ndarje proporcionale të ngarkesës mes prokurorëve në detyrë, ruajtja për aq sa është e mundur e kompetencës së Seksionit të Drejtësisë Penale për të Mitur si dhe në çdo rast respektimi i rregullit të ndarjes vetëm përmes shortimit.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe i njoftohet PP për publikim.

DREJTUESI I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI